

Për nxënësit dhe prindërit/kujdestarët

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka vënë për përdorimin tuaj dy mjete të reja, StudentNet dhe Planin Individual Mësimor (ILP), si ndihmë, që nxënësit të ndjekin progresin arsimor dhe të planifikojnë për të ardhmen. Drejtoria Arsimore kërkon, që gjatë këtij viti mësimor shkollat të punojnë me të gjithë nxënësit nga klasa e katërt deri në 12-te, të përdorin StudentNet dhe të zhvillojnë një ILP. Pësoneli mësimor i shkollës [INSERT SCHOOL NAME] do të punojë me fëmijën tuaj gjatë gjithë vitit, duke përdorur këto burime, për të cilat ne shpresojmë në mbështetjen tuaj të plotë.

Më poshtë janë disa çështje ku ju mund të merrni pjesë dhe të na mbështesni:

- Kërkoni nga fëmija juaj të futet në websaitin StudentNet, bashkë me ju në mënyrë që ta eksplori sëbashku
- Rishikoni arritjet mësimore të fëmijës tuaj në StudentNet dhe i diskutoni ato
- Rishikoni Planin Individual Mësimor të fëmijës (ILP) dhe e diskutoni me të
- Kontaktoni mësuesin këshilltar të fëmijës për pyetje të ndryshme, kërkoni ndihmë dhe/ose sugjeroni përmirësimet e mundshme në planin ILP, që ju dhe fëmija juaj keni zhvilluar sëbashku
- [PER KLASAT K-8] Nëse fëmija juaj harron fjalëkalimin (passwordin), ju lutemi kontaktoni këshilltarin e shkollës
- [PER KLASAT 9-12] Nëse fëmija juaj harron fjalëkalimin e përkohëshëm (passwordin), ju lutemi kontaktoni këshilltarin e shkollës
- Nëse fëmija juaj harron edhe fjalëkalimin e ri, shkoni në faqen e parë të (log-in page) të websaitit [www.philasd.org/login](http://www.philasd.org/login) dhe klikoni në "Forgot Your Password?" në kutinë me ngjyrë blu "Student". Nëse fëmija juaj ka harruar përgjigjen për pyetjen e sigurisë, kërkoni nga mësuesi këshilltar i shkollës të kontaktojë personin e ngarkuar në Drejtorinë Arsimore me numër (215-400-5555).
- Inkurajoni fëmijën tuaj të përdorë vazhdimisht dhe rregullisht StudentNet për të kontrolluar rezultatet mësimore, të përdorë tekstet në internet, dhe të eksplorojë shumë nga resurset që ky websait ofron
- Visitoni [www.philasd.org/offices/studentnet](http://www.philasd.org/offices/studentnet) dhe klikoni në faqen "Resource Materials" për të shkarkuar dokumente të ndryshme (si udhëzuesin ILP dhe synimet SMART) që do t'u ndihmojnë në punën me fëmijën tuaj.
- Regjistrohuni me llogarinë tuaj në FamilyNet nga ku do të keni akses mbi rezultatet mësimore të fëmijës suaj dhe mund të shikoni ILP e tij/saj. Për këtë do t'ju nevojitet datëlindja e fëmijës dhe numrin e ID-së së tij/saj. Për të mësuar se si mund të regjistroheni, shkoni në: <https://phila.schoolnet.com/outreach/philadelphia/parents/>

Materiale të ndryshme mbi StudentNet dhe ILP, që shoqërojnë këtë njoftim, do t'ju japin më shumë informacion të detajuar. Nëse keni pyetje, mos hezitoni të kontaktoni në [PHONE/EMAIL ADDRESS].

Sinqerisht,

[NAME]

Mësuesi Këshilltar

[NAME]

Drejtori i Shkollës